

serbe në **Budakovë/Budakovo**, te vendi i quajtur *Krushicë/Krušica*. E kanë varrosur më 4.07.1998 në varrezat e Budakovës/Budakovo.

Burimet: deklarata A.B, FDH-32528; ICTY, IT-02-54 (S. Milošević), Ex.241 A, FDH-5838; fotografi, FDH-20988; fotografi, FDH-19086; *Serb forces attack two Suhareka villages friday*, newsletter, KIC, 04.07.1998, FDH- 29340; J. Martinsen, *Regjistri...*, FDH-26092; UÇK, *Lista e deshmoreve...*, FDH-36427.

Sadri (Arif) Kryeziu

(28.06.1957, shqiptar nga Suhareka/Suva Reka, tregtar, katër fëmijë)

Sadriu ka punuar në një qoshk gazetash në pronë të *NP Panorama*, i cili ishte i vendosur te ura në **Suharekë/Suva Reka**. Në mëngjesin e datës **8.07.1998**, si zakonisht rreth orës 07:00, Sadriu e ka hapur qoshkun. Atë ditë, me vete e kish marr edhe motrën Gjylen. Rreth orës 8:30, pranë qoshkut u ndal me makinën e vet Miodrag Nišavić, inspektor i Sigurimit Shtetëror në Suharekë/Suva Reka, i cili aty rregullisht i blinte gazeta. Në çastin kur iu afrua qoshkut, mbi të kanë shtënë pjesëtarë të UÇK-së nga distanca prej afro 50 metrash. Polici serb vetëm u plagos, por Sadriu ka mbetur i vdekur në rrethana të pasqaruara. Policia e ka çuar trupin e Sadriut për obduksion në Prizren, ndërkaq, më vonë, trupi iu dorëzua familjes. Varrimi u bë ditën e nesërme, rreth orës 18:00, në varrezat e Suharekës/Suva Reka.

Burimet: deklarata Xh.K, FDH-32551; USCG KGDH, *Regjistri...*, FDH-8817; ICTY, IT-02-54 (S. Milošević), Ex.241 A, FDH-5838; FHP, *Haški tribunal, Sudeenje Slobodanu Miloševiću*, IX, 184; KMKRFJ, *Personat...*, FDH-10832; *Teroristi muçili i ubili 67 nedužnih civila*, Politika, 14.9.1998, <http://www.arhiva.srbija.sr.gov.yu/vesti/1998-09/17/5250.html>; SMIP, *Teroristički...*, III, 395, 911.

Muhamet (Rrustem) Krasniqi

(30.01.1973, shqiptar nga Peqani/Peçane, komuna e Suharekës/Suva Reka, punëtor, një fëmijë, pjesëtar i UÇK-së)

Xhemajli (Avdi) Bytyqi

(26.03.1974, shqiptar nga Peqani/Peçane, ko-

muna e Suharekës/Suva Reka, punëtor, i martuar, pjesëtar i UÇK-së)

Gjatë muajit korrik të vitit 1998, Muhameti dhe Xhemajli i mbanin për ditë stërvitjet ushtarake me regrutë të rinj të UÇK-së. Në mëngjesin e datës **13.07.1998**, si zakonisht, gjendeshin në poligon në afërsi të shkollës filllore *Luftëtarët e Parë të Tivarit* në **Peqan/Peçane**. Papritmas, forcat serbe e nisën bombardimin nga drejtimi i fshatit Shirokë/Široko. Afro 30 predha kanë rënë në poligon gjatë bombardimit. Muhameti dhe Xhemajli u qëlluan për vdekje, ndërkaq shumë të tjerë u plagosën. U varrosën në varrezat e fshatit në orët e mbrëmjes. Pas përfundimit të luftës, më 19.09.1999, mbetjet e tyre mortore janë rivarrosur në Varrezat e Dëshmorëve të Luftës në Suharekë/Suva Reka.

Burimet: deklarata E.F, FDH-10695; deklarata N.E, FDH-976; deklarata S.H, FDH-36851; fotografi, FDH-20988; ICTY, IT-02-54 (S. Milošević), Ex.241 A, FDH-5838; *Names of 2 Killed and 13 Wounded Albanians in Pecan of Suhareka*, newsletter, KIC, 13.07.1998, FDH- 29361; J. Martinsen, *Regjistri...*, FDH-26092; UÇK, *Lista e deshmoreve...*, FDH-36427.

Razë (Reshat) Palushi

(24.04.1985, shqiptare nga Budakova/Budakovo, komuna e Suharekës/Suva Reka, nxënëse)

Për shkak të bombardimeve të shpeshta gjatë muajit korrik të vitit 1998, Razë Palushi me familje largoheshin shpesh nga shtëpia dhe u strehoheshin në bjeshkët e afërta. Në datën **17.07.1998**, situata në **Budakovë/Budakovo** ishte e qetë. Në mbrëmje, rreth orës 22:00, ajo me nënën Asimen dhe vëllain Elmiun vetëm sa e kishin përfunduar darkën, kur filluan bombardime të reja të fshatit. Raza doli jashtë vetëm për një çast që ta derdhte ujin nga labori. Në atë çast, një predhë ka shpërthyer në afërsi të shtëpisë dhe e ka qëlluar për vdekje në vend. Familjarët e kanë varrosur Razën në varrezat e fshatit. Pas përfundimit të luftës, në muajin qershor të vitit 2000, pjesëtarë të KFOR-it i kanë zhvarrosur mbetjet e saj mortore dhe i kanë çuar në Institutin për Mjekësinë Ligjore në Rrahovec/Orahovac. Pas kryerjes së autopsisë në